



Pranuar / Dorezuar Priljeño/Prodato Received / Delivery	28.12.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHACK	8549/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1084/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2033/2021 të datës 06.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A02/148/2015 të datës 27.03.2015 të parashtruar nga ankuesi nga kundër organit të punësimit-Teatri Kombëtar i Kosovës, në çështjen juridike "ndërprerje e marrëdhënies së punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

SHPALLET jo kompetent, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për të vendosur lidhur me ankesën me numër A/02/148/2015 e datës 27.03.2015, të parashtruar nga ankuesi.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar sipas kontratës së punës numër 01/2014, në pozitën "Udhëheqës Artistik i Teatrit të Kosovës", në Teatrin Kombëtar të Kosovës, me vendimin e datës 20.02.2015, të Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës, është shkarkuar nga pozita e Udhëheqësit Artistik të Teatrit të Kosovës.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin e datës 20.02.2015, të Këshillit Drejtues të Teatrit Kombëtar të Kosovës, më datë 19.03.2015 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, më datë 24.03.2015 nxjerr vendim me numër KZKA Nr. 06/2015, me të cilin e ka shpallë veten jokompetent për shqyrtimin e ankesës të parashtruar nga ankuesi

Ankuesi i pakënaqur me vendimin me numër KZKA Nr. 06/2015 të datës 24.03.2015, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me datë 27.03.2015 parashtron ankesën me numër protokolli 1023/2015 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me pretendimet ankimore kundër shkarkimit nga pozita Udhëheqës Artistik i Teatrit të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22/-4/2-15 ka nxjerr Vendim A/02/148/2015 me të cilin ka shpall veten jo kompetent për të vendosur për ankesën e ankuesit. Ankuesi kundër këtij vendimi ha hapur konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative. Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative më datë 06.09.2022 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2033/2022 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar Vendimin A/02/148/2015 të Këshillit, dhe duke e obliguar Këshillin që të udhëzoj palën tek organi kompetent.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 27.03.2015 të ankuesit e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 20.02.2015; Vendimin KZKA Nr.06/2015 i datës 24.03.2015; Kontratës e Marrëdhënies së punës e datës 18.11.2014 për ankuesin; Vendimin e datës 19.03.2014, 28.01.2014, 27.11.2014, 01.10.2014; Emilin e datës 19.12.2014, 22.12.2014, 11.02.2015; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datë 01.04.2015; Përgjigjen në ankesë e datës 07.04.2015; Vendimin me Nr. 4245/2014 i datës 09.10.2014; Procesverbalin e datës 24.03.2015; Vendimin A/02/148/2015 i datës 22.04.2015 i Këshillit; Aktgjykimin A.nr.2033/2021 të datës 06.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë rishqyrtimit të kësaj çështje ka konstatuar se Këshilli nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit pasi që kjo kategori është e përjashtuar nga shërbimi civil sepse është pjesë e krijuesve dhe performuesve të artit, marrëdhënien e tij të punës e ka rregulluar në bazë të nenit 10 paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 04/L-106 për Teatrot, me Ligjin e Punës, siç parashihet me neni 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet: *"Në bazë të këtij Ligji statusi i nëpunësve civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe performuesit të artit, zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganorë të Doganave të Kosovës, zyrtarët korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës, dhe prestarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarët e kabineteve të tyre, që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe kabinetet e ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta, marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale."* Po ashtu Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pozita e drejtorit artistik të Teatrit Kombëtar të Kosovës është përcaktuar në kategorinë e krijuesve dhe




përformuesve të artit dhe kulturës sipas nenit 8 paragrafi 1.1 të Rregullores Nr. 05/2011 për Gradimin dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesional të Trashëgimisë Kulturore, si rrjedhojë me nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përcaktohet që Këshilli është kompetent të shqyrtoj dhe të vendos vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në konstatimin si më lartë dhe duke marr për bazë Aktgjykimin A.nr.2033/2021 të datës 06.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, udhëzon palën ankuese që lidhur me pretendimet e tij për ndërprerje të marrëdhënies së punës t'i drejtohet Gjykatës Kompetente në pajtim me nenin 79 të Ligjit Nr. 03/L-212 Të Punës

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda,1084/2022,datë 28/12/2022

Aydyll BEKTESHI



Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit,
- Znj. Gjyqtare në Gjykatën Themelore-DA, në Prishtinë;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Arkivit të KPMSHCK.

